



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

FAKULTETI I ARTEVE

1. Përmbajtja e shkurtër e programit të studimeve themelore Baçelor

Emri i programit të studimit	Arte Performuese
Niveli i kualifikimit sipas KKK (me shkurtesat BA, MA, PhD, program	Niveli VI BA
Numri i ECTS Kredive	240
Grada Akademike (Kualifikimi i fituar)	Bachelor i Arteve -Arte Performuese (BA)
Kohëzgjatja e programit të studimit (sipas vendimit të AKA-së)	2025-2030
Kohëzgjatja minimale e studimeve	4 vit / 8 semestra

2.Qëllimi dhe objektivat e programit të studimit:

Qëllimi fushën e arteve, zhvillon , pregadit profesionistë të aftë dhe mbështet jetën artistike duke përmbushur nevojat e shoqërisë e cila përputhet me rezultatet e të nxënës të programit siç janë: -Interpreton si solist në instrument muzikor/

Flautë/Klarinetë/Trumpet/Saksofon/Fagot/Trombon/Violinë/Violë/Violonçelë/Kontrabas/Piano/Kitare. - Interpreton si solist (për solokëngëtar) në kore. - Interpreton si anëtar në orkestër. -Interpreton si anëtar në kor. - Interpreton si instrumentist ose vokalist në muzikë dhome dhe ansamble kamertale .

Poashtu rezultatet e programit përputhen edhe me vizionin e Fakultetit si : 'Fakulteti i Arteve synon të mbetet model i arsimit të lartë publik i karakterizuar nga përgatitjet profesionale akademike, për të krijuar, zhvilluar dhe përcjell dijet nëpërmjet mësimdhënies, në fushën e artit dhe të kulturës, si dhe nxisë dhe zhvillojë kërkimin artistik /shkencor'.

Vizion i cili përputhet me rezultatet si: - Zotëron , teknikat,format dhe mënyrat e performimit muzikor. -Udhëheq performancat e orkestrave dhe ansambleve vokalo-instrumentale .

3. Rezultatet e pritshme të mësimi të programit::

Rezultatet e synuara të programit Arte performuese janë:

Studenti :

1.Interpreton si solist në instrument muzikor/

Flautë/Klarinetë/Trumpet/Saksofon/Fagot/Trombon/Violinë/Violë/Violonçelë/Kontrabas/Piano/Kitare.

2. Interpreton si solist (për solokëngëtar) në kore.

3. Zotëron , teknikat,format dhe mënyrat e performimit muzikor.

4. Interpreton si anëtar në orkestër.

5. Interpreton si anëtar në kor.

6. Interpreton si instrumentist ose vokalist në muzikë dhome dhe ansamble kamertale.

7. Udhëheq performancat e orkestrave dhe ansambleve vokalo-instrumentale.

4.Procedurat e mësimdhënies:

Programi Arte performuese është strukturuar në ketë formë:

A. Viti I-rë ka 7 lëndë obligative dhe një zgjedhore në të cilat merrën njohuritë baze ndërdisiplinore dhe korrespondojnë me të gjitha modulet tjera; B. Viti II-të ndahet në katër module:

□ **Moduli Instrumenteve Frymore;**

□ **Moduli Instrumenteve Harkore;**

▣ **Moduli Solokëndim;**

▣ **Moduli Instrumenteve Piano/Kitare;**

C. Viti II, III dhe IV në këto vite do të merren njohuritë profesionale për të gjitha modulet.

Lëndët varësisht nga ngarkesa e tyre kanë 3 deri 10 kredi, por ato dallojnë për nga shtrirja kohore dhe lloji i aktiviteteve në të cilat angazhohen studentët.

Disa lëndë kanë më shumë ushtrime e punë praktike, e disa më pak. Pra, kjo është një arsye pse nuk kanë numër të njëjtë të kredive, ato dallohen për nga numri i orëve që parashihet për punë praktike, të pavarur e hulumtime nga studenti.

Shembull: Një lëndë prej 4 ECTS/100 orë pune mund të llogaritet si në vijim:

- Orë mësimi me mësimdhënësin: ligjëratat 2 orë/në javë x 15 javë/një semestër = 30 orë.
- Konsultimi me mësimdhënësin: 5 orë.
- Koha e studentit për mësim individual (e llogaritur): puna në projekt = 30 orë.
- Detyrat e shtëpisë dhe mësimi individual = 15 orë.
- Përgatitja për provime = 20 orë.

5.Procedurat dhe llojet e vlerësimit të përdorura (notimi i studentëve)

10	Shkëlqyeshëm: Rezultate të shkëlqyera me gabime të arsyeshme
9	Shumë Mirë : Njohuri mbi mesatare me disa gabime
8	Mirë: Rezultate solide
7	Në Rregull: Njohuri të mira, me mangësi
6	Mjaftueshëm: Njohuri, plotëson kërkesat minimale
5	Dobët: Njohuri të mangëta, nuk i plotëson kërkesat minimale

6.Perspektiva e studentit(ku mund t; pun;sohet pas diplomimit)

Pas diplomimit, studentët do të mund të ndjekin karrierën si muzikantë, si solist në instrumentin përkatës ,anëtarë të orkestrave apo në ansamble të muzikës së dhomës, dhe të jenë aktiv si pedagog në shkollat e ulëta dhe të mesme profesionale.

7.Kostoja e studimeve

Në bazë të udhëzimit administrativ me nr.09/2021 të MASHT ,studentët që studijojnë në Universitetet publike të Republikës së Kosovës janë të liruar nga shpenzimet administrative për studime në ndonjë program në nivelin Bachelor dhe Master.